



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM

Nr. 301, datë 13.07.2021

PËR

**DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR
TË PROCEDURËS SE VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR
Z.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 53 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe pikat 18 dhe 25, seksioni C, kreu IV, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, z. Medi Bici,

VENDOSI:

1. Deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, për z. {...}, të filluar me vendimin nr. 498, datë 21.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të humbjes prej tij të statusit të kandidatit fitues për ndihmës ligjor, në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2020 – 2021.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR